



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.320/2019

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesuese, Adnan Konushevi dhe Faton Ademi anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares së lartë ligjore Valbona Millaku Foniqi, duke vendosur përkitazi me ankesën e Organizatës Joqeveritare BIRN dhe Internews Kosova, me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, për shkak të shpërndarjes së materialit zgjedhor në rrugë publike gjate heshtjes zgjedhore, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të datës 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur me datë 07.10.2019, mori këtë:

VE N D I M

Refuzohet e pabazuar ankesa Anr.320/2019 e datës 06.10.2019, e Rrjetit Ballkanik për Gazetari Huluntuëse (BIRN) dhe Internews Kosova (IKS), me seli në Prishtinë, kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë.

A r s y e t i m

Parashtruesi i ankesës, Rrjeti Ballkanik për Gazetari Huluntuëse (BIRN) dhe Internews Kosova (IKS), me seli në Prishtinë, me datën 06.10.2019, ka paraqitur ankesë në PZAP, në të cilën pretendon se me datë 06 Tetor 2019, rreth orës 10:00, në komunën e Prishtinës në afërsi të shkollës fillore “Emin Duraku”, gjendet kartëvizita afër 2 metra në hyrje të kësaj shkolle i kandidatit për deputet Mefail Bajqinovci, me numër 20 nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje.

Sipas paraqitësit të ankesës vendosja e posterave në afërsi të institucioneve publike është në kundërshtim me Rregullën zgjedhore Nr.13/2013, fushata e zgjedhjeve dhe njoftimi për ngjarje politike përkatësisht neni 3.4.

Paraqitësi i ankesës në mbështetje të pretendimeve në ankesë, si dëshmi ka bashkangjitur fotografi të printuar.

Në përgjigjen në ankesë të datës 07.10.2019, subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje, thekson se kartëvizita nuk është hedhur nga asnjë aktivistë në vend, mirëpo meqenëse kartëvizita është material i lëvizshëm, ka mundur ndonjë qytetar i cili e ka marrë ndonjë kartëvizite me herët të hedhe në afërsi të asaj shkolle. Përveç kësaj në përgjigje në ankesë theksohet se foto e cila është fotografuar në tokë dhe objekti i shkollës nuk kanë asnjë lidhje vizuale, pra është fotografuar një kartëvizitë dhe në një foto tjetër është fotografuar një shkollë e cila pretendohet të jetë shkolla Emin Duraku në Prishtinë.

Paneli, pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se:

Ankesa është e pabazuar

PZAP-i, pas vlerësimit të provave të bashkangjitura në ankesë vërtetoi se ankesa e parashtruar nuk bazohet në dëshmi të qarta dhe bindëse të përcaktuar me nenin 117 paragrafi 3 i LZP-së. Kjo për faktin se nga vizitkartat e shpërndara nuk mund të identifikohet personi i cili ka bërë shpërndarjen e tyre. Andaj paneli përfundoi se janë të paqëndrueshme përshkrimet në ankesë se subjekti politik Lëvizja VetëVendosje (LVV) ka thyer Rregulla 13/2013 neni 3 pika 3.4 nga subjekti politik Lëvizja VetëVendosje (LVV).

Nga arsyet e theksuara si me lart e në kuptim të neneve 115 paragrafi 1, neni 117 paragrafi 3 neni 118 paragrafi 1 të LZP-së, lidhur me nenin 5 paragrafi 7 i Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, Nr.02/2015, Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Anr.320/2019 më datën 07.10.2019

Kryesuese e Panelit
Gyltene Sylejmanj



Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.